



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit**

Data	
Nr. Prot	

**RELACION**

**PËR PROJEKTVENDIMIN**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË SHIJAK, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË", ZJ. MIMOZA SHEFQET XHIHANI**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Me shkresën nr. 5617 prot., datë 7.12.2023, Këshilli i Bashkisë Shijak, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari, z. Igli Isa Bardhi, propozuar nga subjekti politik "Partia Socialiste e Shqipërisë".

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", për Këshillin e Bashkisë Shijak, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit, është kandidati me numër rendor 14, zj. Mimoza Shefqet Xhiani.

Me shkresën nr. 7864, prot., datë 18.12.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, zj. Mimoza Shefqet Xhiani, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e Këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për Këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit "Partia Socialiste e Shqipërisë", ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 46 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i Këshilltarit të Bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Mimoza Shefqet Xhiani, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 7967 prot., datë 26.12.2023, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 7968 prot., datë 26.12.2023, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Mimoza Shefqet Xhiani.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 18828/1 prot., datë 11.1.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Mimoza Shefqet Xhiani, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 16934/1 prot., datë 12.1.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Mimoza Shefqet Xhiani, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Mimoza Shefqet Xhiani, në Këshillin e Bashkisë Shijak, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e Këshilltarit.

**Jona JOSIFI** -Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe Monitorimit

**Majlinda ÇELMETA** -Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

**Ylli MERKAJ** -Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË SHIJAK, ME KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË", ZJ. MIMOZA SHEFQET XHIHANI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 5617 prot., datë 7.12.2023, Këshilli i Bashkisë Shijak, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari, z. Igli Isa Bardhi, propozuar nga subjekti politik "Partia Socialiste e Shqipërisë".

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", për Këshillin e Bashkisë Shijak, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit, është kandidati me numër rendor 14, zj. Mimoza Shefqet Xhiani.

Me shkresën nr. 7864, prot., datë 18.12.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shijak, zj. Mimoza Shefqet Xhiani, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve

Data: dd mm vvvv Nr:

Ora: hh:mm



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shijak me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialiste të Shqipërisë", zj. Mimoza Shefqet Xhiani".

të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e Këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për Këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 46 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i Këshilltarit të Bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Mimoza Shefqet Xhiani, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, me shkresën nr. 7967 prot., datë 26.12.2023, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 7968 prot., datë 26.12.2023, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Mimoza Shefqet Xhiani.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 18828/1 prot., datë 11.1.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Mimoza Shefqet Xhiani, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 16934/1 prot., datë 12.1.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Mimoza Shefqet Xhiani, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Mimoza Shefqet Xhiani, në Këshillin e Bashkisë Shijak, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e Këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

## V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shijak, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, zj. Mimoza Shefqet Xihani.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë ) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**